

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 14.7 të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35, në parashkrimin se të gjithë Nëpunësit mundë të marrin pjesë në Fondin e Pensionit, veq nëse një Fondi i tillë i Pensionit është me qëllim vetëm për nëpunësit që ju takojnë kategorive profesionale të specifikuara,

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK), në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2002 miraton si vijon:

Rregulla 19 mbi pjesmarrjen në Fondin e Pensionit dhe Kategoritë profesionale të nëpunësve

Neni 1 Sfera dhe qëllimi i rregullës

1.1 Sfera e Rregullës

Kjo Rregull i adresohet Fondit të Pensionit Pundhënës Suplementar (Fondi i Pensionit).

1.2 Qëllimi i Rregullës

Kjo Rregull zbaton kërkesat jo diskriminuese për një program të Pensionit të sponzoruar Pundhënës në lidhje me pjesmarrjen e nëpunësve në Fondin e Pensionit.

Neni 2 Dispozitat e përgjithshme

2.1 Definimi

Të gjitha termet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar në Rregulloren e Pensionit dhe/ose siq do të definohen më pas në këtë Rregull.

“Rreziku biometric” nënkupton ekspozimin e pjesmarrsit ndaj rrezikut të shoqëruar me jetën, aksidentin, invaliditetin dhe shëndetin. Masat e rrezikut biometric dhe stabilizimi

përfshijnë dhënjën e debive (qimim shtesë) dhe/ose kredi (zbritje) në shfrytzim dhe aplikimin e mortalitetit dhe/ose shkallës së sëmundjes.

“Nëpunës” nënkupton dhe përfshinë qdo individ që ka një kontratë efektive të punsimit me Pundhënësin sipas termeve të tilla dhe kushteve që krijojnë një “Marrdhënje Pundhënës-Nëpunës” sikur që është definuar sipas ligjeve Legjislative Shoqrore dhe të Punës.

“Nëpunësit e pranueshëm” ose “Nëpunësit e pranueshëm për pension”, nënkupton ndonjerin ose të gjithë nëpunësit që mundë të marrin pjesë në Fondin e Pensionit si një qështje e drejtë.

“Marrveshja kolektive” nënkupton procesin nëpërmes të cilave kushte të punës, pagesa dhe benefitet e nëpunësve janë negociuar dhe pajtuar për, në “Marrveshjen Kolektive” ndërmjet Pundhënësit dhe Nëpunësit.

“Sindikata e puntorëve” ose “Unioni” i referohet organizatës së organizuar të puntorëve e njohur nga Pundhënësi si “Njësi e marrveshjes kolektive” për një pjesë ose gjithë nëpunësit e Pundhënësit.

“Menagjmenti” ose “Menagjerët” i referohen kategorisë së nëpunësve që ushtrojnë rolin e drejtuesit, mbikqyrësit dhe kontrollit të punës së zhvilluar të mbikqyrësve, stafit dhe nëpunësve të thjeshtë dhe në kartotekë.

“Nëpunësit permanent” përfshin të gjithë nëpunësit e klasifikuar si të tillë në pajtim me politikën e klasifikimit të personelit të Pundhënësit në pajtim me dispozitat e aplikueshme të ligjit Legjislativ Shoqëror dhe të Punës. Në qdo rast një nëpunës i cili është në shërbim të vazhdueshëm me Pundhënësin për periodën më së paku prej një viti, për qëllime të kësaj Rregulle, mendohet që të jetë nëpunës permanent.

“Nëpunësit profesional” përfshinë ata nëpunës të kategorizuar si menagjment, mbikqyrës dhe staf dhe përgjithsisht janë të paguar me vlera fikse që nuk janë në lidhje me orët aktuale të punës.

“Rank and file”(punonjësit që nuk janë mbikqyrës) nënkupton dhe përfshin gjithë nëpunësit ndryshe nga kategorit e nëpunësve profesional.

“Stafi” i referohet kategorisë së nëpunësve që asistojnë, punojnë sipas urdhërave dhe raportojnë direkt nëpunësve profesional.

“Mbikqyrsi” i referohet kategorisë së nëpunësve të cilët caktojnë dhe mbikqyrin punën e nëpunësve tjerë.

“Nëpunësit e përkohshëm” përfshinë të gjithë nëpunësit të cilët nuk janë nëpunës permanent.

“Antarët e sindikatës” i referohen atyre nëpunësve që janë antarë të Unionit të Puntorëve.

Neni 3 **Pjesmarrja në Fondin e Pensionit**

3.1 Rregullat e përgjithsme

Të gjithë nëpunësit permanent pavarësisht prej kategorisë mundë të marrin pjesë në Fondin e Pensionit që sponzorohet nga Pundhënësi. Mirpo, lidhur me kushtet e përmendura në Nën-seksionin 3.2 të këtij Seksioni, Fondi i Pensionit mundë të sigurojë për benefitet e pensionit dhe pjesmarrjen e nëpunësve që ju takojnë kategorive profesionale specifike, nëse një kategori e tillë ose kategoritë, siq është definuar në këtë Rregull , janë përcaktuar qartë në Urdhëresën e Pensionit.

3.2 Rregullat specifike për pjesmarrje në Fondin e Pensionit bazuar në kategoritë profesionale të nëpunësve

Urdhëresa e Pensionit (Akti normativ) mundë të ofrojë për rregullimin pensional që mundë të adresohet vetëm për kategorinë specifike ose kategoritë e nëpunësve nëse një kategori e tillë ose kategoritë janë të definuara qartë dhe të caktuara në Urdhëresën e Pensionit dhe në lidhje me kushtet si vijojnë:

- a) Pjesmarrsit e pranueshëm nuk janë të kufizuar vetëm për nëpunësit që ju takojnë kategorive të përfshira sipas definimit të nëpunësve profesional.
- b) Pjesmarrja nuk është e kufizuar vetëm për antarët e Unionit.
- c) Pjesmarrja mundë të kufizohet vetëm për nëpunësit e kategorizuar si “rank and file”.
- d) Pjesmarrja mundë të kufizohet vetëm për nëpunësit e kategorizuar si “mbikqyrës” dhe “rank and file”.
- e) Pjesmarrja mundë të kufizohet vetëm për nëpunësit e kategorizuar si “staf” “mbikqyrës” dhe “rank and file”.
- f) Pjesmarrja mundë të kufizohet për grup moshën speciale që nuk është mbuluar nga dispozitat e obligueshme në pensionet e kursimit.
- g) Në rregullimin pensional që ofron benefitet e pensionit bazuar në rrezikun biometric (si p.sh. invaliditeti, aksidenti, benefitet e vdekjes ose shëndetsore),

pjesmarrja mundë të kufizohet për disa lloje të nëpunësve ku natyra e tyre e punës involvon ekspozim të ngjajshëm ndaj rrezikut biometric, si psh., por jo i kufizuar për, kategoritë si vijojnë, ose nën-kategoritë, bazuar në standarde të arsyeshmë dhe uniforme të klasifikimit biometric:

- (i) Puntorët e linjës dhe procesit për fabrikat që përpunojnë ose prodhojnë të mira dhe jetgjate.
- (ii) Elektricitetët, ingjinerët, puntorë krahu dhe nëpunës tjerë teknik.
- (iii) Personeli i sigurimit, zjarrfiksat, dhe kategoritë si këto.
- (iv) Minatorët dhe personeli operues i minierës.
- (v) Kategoritë e tjera që konsiderohen se ju takojnë rrezikut të ngjajshëm biometric dhe të mbështetur nga një sërë speciale korresponduese e Supozimeve Aktuariale.

Neni 4 **Pranueshmëria e fillimit të pjesmarrjes**

4.1 Për pensionet me Kontribut të Definuar

Urdhëresa mundë të specifikojë disa kërkesa për pranim për pjesmarrjen e nëpunësve në Fondin e Pensionit me Kontribut të Definuar duke siguruar se kërkesat e tilla sigurojnë se:

- a) Asnjë nëpunës permanent që i takonë një kategorie të pranueshme, nuk përjashtohet.
- b) Pjesmarrja dhe fillimi i kontributeve për dhe në emër të pjesmarrsit hyn në fuqi në ditën kur nëpunësi fiton statusin e asaj/atij si nëpunës permanent.

4.2 Për pensionet me benefit të definuar

Urdhëresa mund të specifikojë disa kërkesa për pranim për pjesmarrjen e nëpunësve në Fondin e Pensionit me Benefit të Definuar duke siguruar se kërkesat e tilla sigurojnë se:

- a) Asnjë nëpunës permanent që plotson kërkesat e pranueshmërisë, nuk përjashtohet.
- b) Kërkesat tjera të pranueshmërisë konsistojnë në:
 - 1. Periodën kualifikuese të punimit të vazhdueshëm para pjesmarrjes, e cila periodë nuk duhet të tejkaloj periodën prej një viti.

2. Numri minimal i orëve të punuara dhe të paguara gjatë asaj periodës kualifikuese prej një viti, i cili numër i orëve minimale nuk mund të tejkaloj 1,500 orë.

- c) Fillimi i kontributeve për dhe në emër të pjesmarrësit hyn në fuqi në ditën kur nëpunësi plotson të gjitha kërkesat për tu zgjedhur.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull do të hyj në fuqi më 23 tetor 2002.

Drejtori i Përgjithshëm